



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

V E N D I M

Nr.194, datë 5.4.2019

PËR

KTHIM FONDI NË BUXHETIN E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Shtetit për Diasporën

V E N D O S I:

1. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, të kthejë në fondin rezervë të buxhetit të shtetit shumën prej 14 561 598 (katërmëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, fond i papërdorur nga fondi shtesë, i akorduar me vendimin nr.11, datë 9.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, me qëllim organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës.
2. Ky fond kalon nga zëri “Shërbime qeveritare” i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në fondin rezervë të buxhetit të shtetit, brenda muajit prill 2019.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A